



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**PROCEDURAT E REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË
TË STUDIMEVE NË UNIVERSITETET FRANCEZE,
VITI AKADEMIK 2017-2018**

Në kuadrin e Bashkëpunimit Kulturor, Ambasada e Republikës së Francës në Tiranë njofton se ka filluar fushata e para regjistrimit 2017-2018 për kandidatët e huaj në ciklin e parë të studimeve (universitete dhe shkollë arkitekture) në Francë. Materialet e aplikimit për pranimin paraprak mund të tërhiqen pranë zyrave të Shërbimit të Bashkëpunimit dhe Veprimt Kulturor të kësaj Ambassade, duke filluar nga data deri **05 dhjetor 2016**, çdo ditë, nga e hëna në të enjte, ora 14:30-17:00. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dosjet e plotësuar në Ambasadë duke filluar nga data **19 dhjetor 2016** deri në **23 dhjetor 2016**, ose nga data **03 janar 2017** deri në **20 janar 2017** që është dhe afati i fundit për aplikim (nga e hëna deri të enjten, midis orës 14:30 dhe 16:30).

Procedura e aplikimit:

Mbas dorëzimit të dokumentacionit, aplikantët duhet të provojnë se kanë nivelin B2 nëpërmjet DELF-it ose TCF DAP. Lidhur me kete kriter, kandidatët do t'i nënshtrohen një provimi lidhur me njohjen e gjuhës frënge (TCF), i cili do të organizohet në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës në datën **08 shkurt 2017**, nga ora **9:00-13:00**. Ky provim është i detyrueshëm për të gjithë aplikantët, me përjashtim të nxënësve të seksioneve dygjuhëshe dhe nxënësve që kanë nivelin DELF B2 dhe DALF C. Në momentin e dorëzimit të dosjes së regjistrimit, kandidati që do të kalojë testin TCF DAP duhet të paguajë 69 €.

Për më tepër informacion mbi procedurën e regjistrimit paraprak (e cila realizohet në gjuhën frënge), kandidatët shqiptarë duhet t'i referohen adresave online në vijim:

<http://www.ambafrance-al.org/Procedures-d-inscription-en-ler-cycle-universitaire-en-France-pour-I-anee-2017;>

[http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html;](http://www.enseignementsup-recherche.gouv.fr/pid24665-cid24144/-dossier-blanc-demande-prealable-a-une-inscription-en-premier-cycle.html)

<http://www.archi.fr/ECOLE/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE